



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:082084

Datë: 26.06.2019

Numri i dokumentit: 00378002

PKR.nr. 50/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, duke vendosur sipas kryetarit të trupit gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të pandehurit **F. M.** nga fshati Cërnicë, Komuna e Gjilanit dhe të akuzuarit **D. H.**, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti për Krimet e Rënda, PP. I.nr.57/2019 e dt. 29.03,2019 e pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik me dt.21.06.2019, shpall dhe përpilon

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurit **F. M.** nga babai nëna e lindur Zeqiri, i lindur me dt. në fshatin Cërnicë, Komuna e Gjilanit ku edhe jeton, ka të kryer shkollen e mesme, i pamartuar, i punësuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal

ËSHTE FAJTOR

Sepse me datën 22.03.2019, rreth orës 13:00, në rrugën Gjilan- Ferizaj, afër rrugës së fshatit Zheger, në restorant Cometa, gjatë bastisjes nga ana e zytarëve policor në arkën e cila gjendet në lokalin e kazionos është gjetur arma e markës Zoraki M 906-B, me nr.serik 000286, 1 karikator dhe 100

fishekë të kalibrit të pa njohur , të cilën armë e ka mbajtur në pronësi në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

-me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj në bazë të nenit 4,41,42,43,46,69,73,74,75,76 dhe nenit 365, 450 të KPPK-së,

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 500 €(pesëqind euro) , të cilin gjobë I pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, ashtu që për çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, kësaj gjykate ti paguaj shumën prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës do të paguhën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

Konfiskohen: Arma e markës Zoraki M 906-B, me nr.serik 000286, 1 karikator dhe 100 fishekë të kalibrit të pa njohur, e pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjtat të asgjësohen.

Veçohet procedura penale ndaj të pandehurit D. H., për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-së , me propozim të prokurorit të shtetit.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Renda, me dt. 29.03.2019, ka ngritur aktakuzën PP/I nr. 57/2019, ndaj të akuzuarve D. H. dhe F. M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të

KPRK-se, duke kërkuar që pas mbajtes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të pandehurit të shpallen fajtor dhe të denohet me dënim meritator sipas ligjit.

Kryetari i trupit gjykues, me datën **19.06.2019**, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, ku është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës I pandehuri **D. H.** ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën e lexuar, nuk e pranon fajësinë për veprën penale.

I pandehuri **F. M.** ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga **neni 374 paragrafi 1 te KPRK-se**.

Gjatë shqyrtimit fillestar dhe publik kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, nga se janë plotësuar kushtet ligjore dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje me provat që gjinden në shkresat e lëndës edhe atë: **Raporti i oficerit me nr. 2019 CP-14 të dt. 23.03.2019, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e dt 22.03.2019, deklarata e të pandehurit F. M. e dhënë më dt. 23.03.2019, si dhe fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes.**

Kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se e njëjta nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqyrtimit të dënimit, konform dispozitave 73 dhe 74, dhe 76 të KPRK-së, gjykata ka marr për bazë rrethanat që ndikojn në llojin dhe lartësin e dënimit. Në këtë aspekt kryetari i trupit gjykues si rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marr parasysht, pranimin e fajësisë, është penduar dhe ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i

premtion gjykatë që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale dhe gjendjen e rëndë ekonomike , ndërsa gjykata nuk gjeti rrethana rënduese për të pandehurin.

Sipas Kryetarit të Trupit Gjykses, dënimi me gjobë në shumë prej 500 euro (pesëqind) Euro, është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe gjendjen financiare të tij, andaj konform nenit 41 të KPRK-se gjykata vlerëson se me këtë dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston në parandalimin e kryesit që në të ardhmen të kryej vepra tjera penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-se, të pandehurit iu ka **konfiskuar Arma e markës Zoraki M 906-B, me nr.serik 000286, 1 karikator dhe 100 fishekë të kalibrit të pa njohur**, e pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi arma dhe fishekët do të asgjahohen.

Kryetarit i trupit gjykses ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën paushalle ne vlerë prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogaris përfundimtare të kësaj gjykate.

Gjykata pas propozimit të prokurorit të shtetit ka marr aktvendim për **VEÇIMIN E** procedurës penale ndaj të pandehurit **D. H.**, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 te KPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA
Me dt. 21.06.2019

Sekretare juridike
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykses
Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët e paknaqura mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.